Numër: 01-956 Datë: 08.10.2026

Në mbështetje të neneve 6,8,9 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Rregulloren Nr. 01/196 e punës së Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë: 07.10.2026 merr:

V E N D I M

1. Akreditohet dhe Validohet Instituti Profesional (OJQ) "Fondacioni Sheikha Fatima bint Mubarak për Gruan". Adresa: Rr. Nënë Tereza, nr. 84, Fushë Kosovë, për periudhën tre (3) vjeçare (07.10.2026 – 06.10.2029), për kualifikimet:

1.1. **Bërës Ëmbëlsirash**, me numër total të kredive (5) Kualifikim i bazuar në Kualifikimet Kombëtare Profesionale D (Niveli 3). Aktivitetet organizohen në 4 grupe paralele për cikël, ku secili grup do të përbëhet nga 6 kandidatë. Gjatë një viti mund të organizohen 2 cikle, ku në një cikël marrin pjesë 24 kandidatë, me një kapacitet total prej 48 kandidatëve për një vit.

1.2. **Parukier**, me numër total të kredive (15). Kualifikim i bazuar në Kualifikimet Kombëtare Profesionale D (Niveli 3). Aktivitetet organizohen në 1 grup për cikël, ku secili grup do të përbëhet nga 8 kandidatë (harmonizuar me kapacitetin prej 8 vendeve të punës). Gjatë një viti mund të organizohen 6 cikle, me një kapacitet total prej 48 kandidatëve për një vit.

1.3. **Grimier/e**, me numër total të kredive (10). Kualifikim i bazuar në Kualifikimet Kombëtare Profesionale (Niveli 3). Aktivitetet organizohen në 2 turne, ku secili grup do të përbëhet nga 12 kandidatë (të mbështetur nga 6 poste pune dyshe aktive). Gjatë një viti mund të organizohen 4 grupe, me një kapacitet total prej 48 kandidatëve për një vit.

1.4. **Manikyrist**, me numër total të kredive (4). Kualifikim i bazuar në Kualifikimet Kombëtare Profesionale D (Niveli 3). Aktivitetet organizohen në 2 grupe (dy turne) për ciklë, ku secili grup do të përbëhet nga 10 kandidatë (me gjithsej 20 kandidatë për ciklë). Gjatë një viti mund të organizohen 5 cikle, me një kapacitet total prej 100 kandidatëve për një vit.

1.5. **Pedikyrist**, me numër total të kredive (4). Kualifikim i bazuar në Kualifikimet Kombëtare Profesionale D (Niveli 3). Aktivitetet organizohen në 2 grupe (me dy turne) për cikl, ku secili grup do të përbëhet nga 10 kandidatë (me gjithsej 20 kandidatë për cikl). Gjatë një viti mund të realizohen 5 cikle me nga 2 grupe (në total 10 grupe), me një kapacitet total prej 100 kandidatëve për një vit.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së OJQ *"Fondacioni Sheikha Fatima bint Mubarak për Gruan"* të parashtruar në AKK, për akreditim dhe validim të OJQ-së për kualifikimet: ***Bërës Ëmbëlsirash, Parukier, Grimier, Manikyrist dhe Pedikyrist***, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) bazuar në dispozitat ligjore në fuqi ka caktuar ekipet e ekspertëve të jashtëm me qëllim të vlerësimit të institucionit lidhur me përmbushjen e kritereve për akreditim dhe validim.

Ekipi i ekspertëve pas shqyrtimit të dosjeve të aplikimit më 22.04.2026 dhe vizitave në terren më 07.05.2026 si dhe pas finalizimit të raporteve vlerësuese më 12.06.2026 i ka proceduar gjetjet për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 07.10.2026.

Rekomandimet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve janë mbështetur në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit si: aplikacionet për validim të kualifikimeve, aplikacionet për akreditim të institucionit, raportin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni, si dhe të gjeturave me rastin e realizimit të vizitave tek pala aplikuese.

AKK bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr.03/L-060 Për Kualifikimet Kombëtare dhe nenin 23 të Udhëzimit Administrativ MASHI Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, është e obligуar të realizojë procesin e monitorimit dhe të raportojë tek Këshilli Drejtues i AKK-së.

Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së, referuar dispozitave ligjore, rekomandimeve të ekipit të ekspertëve të dhëna në raportet vlerësuese përfundimtare për akreditim dhe validim të institucionit aplikues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD së AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.*

Vendimi u dërgohet:

1. "Fondacioni Sheikha Fatima bint Mubarak për Gruan"
2. Arkivit të AKK.

Prof. Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD-së së AKK